



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN

**RAPORT I PUNËS SË
PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN
PËR VITIN 2016**

SHKURT, 2017

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2016

- Respektimin e të drejtave të njeriut;
- Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktime;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional;
- Bashkëpunimin ndërkombëtar;
- Përdorimin e metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive;
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre;
- Infomacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrajnë Funksione Publike;
- Problematikat e hasura.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË PËR VITIN 2016

- Volumi i punës në hetim;
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë;
- Treguesit kryesorë të punës së Prokurorisë Kurbin për vitin raportues;
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale;
- Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror;
- Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë;
- Kriminaliteti sipas peshës (numrit më të madh të procedimeve) së veprave penale;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).

III. ANALIZA KRAHASIMORE 2 VJEÇARE E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

- Treguesit statistikorë për numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të regjistruar, numrin e të pandehurve dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve të dënuar.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË KURBIN PËR VITIN 2016

- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve;
- Të dhëna për gjykimet e posaçme;
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve;
- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit;
- Të dhëna për të pandehurit e mitur;
- Të dhëna për pasojat e veprave penale.

V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

- Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë);
- Letërporositë (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë);
- Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit);
- Transferimet e procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashtë, transferimet e procedimeve për jashtë);
- Transferimet e personave të dënuar (transferimet e personave të dënuar nga jashtë, transferimet e personave të dënuar për jashtë);
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.

VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME

I- DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2016

Viti 2016, për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka qenë viti i një angazhimi të gjithëanshëm, në funksion të realizimit të detyrave kushtetuese që ka Prokuroria, si organ i ndjekjes penale. Ngarkesa që kemi përballuar këtë vit, treguesit që kemi shënuar në të gjitha drejtimet e ndjekjes penale dhe në përfaqësimin e akuzës në gjykim, flasin për punë me ndjenjë të lartë përgjegjësie, nga të gjithë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe administrata e kësaj prokurorie.

Në këtë raport, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin si organ i ndjekjes penale analizon veprimtarinë e punës së periudhës 1-vjeçare për vitin 2016, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtron veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese si institucion dhe prokurorëve që përfaqësojnë atë, arritjet, problemet dhe mangësitë e evidentuara si dhe përcaktimin e prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për rritjen e performancës në veprimtarinë e saj në të ardhmen.

Gjatë vitit 2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti është kryer bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar njëkohësisht urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në fokus të veprimtarisë së punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka qenë lufta dhe ndëshkimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar si fenomene të përhapura që kanë qenë pengesë në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Kështu në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin për vitin 2016 janë referuar dhe regjistruar 3 raste të korrupsionit sipas nenit 259 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike” dhe një rast i mbartuar nga viti 2015. Për të katër rastet në fjalë janë marrë të pandehur 2 persona dhe janë dënuar 2 persona me arrest në burg.

Janë referuar nga Policia e Shtetit, nga individë dhe subjekte të tjera, 3 raste për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilat janë dërguar në gjykim 2 raste dhe një rast është ende në hetim.

Përsa i përket grupit të veprave në lidhje me krimin e organizuar dhe krimet e rënda janë regjistruar 22 procedime penale për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Prej tyre 6 janë dërguar për gjykim me 8 persona të pandehur dhe 6 të arrestuar. Ndërsa për grupin e veprave të parashikuara nga neni 284/a dhe 284/b janë regjistruar 60 procedime penale dhe janë në proces 15 procedime të mbartura nga viti 2015 nga të cilat 1 rast është pushuar, 56 janë pezull, 8 raste janë transferuar dhe 6 janë dërguar në gjykatë me 8 persona të pandehur.

Përsa i përket grupit të veprave të pastrimit të parave janë regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe për të tre rastet vazhdojnë hetimet, pasi ato shtrihen në territorin e vendit dhe jashtë.

Për të përmirësuar më tej performancën në të gjithë treguesit e saj do të fokusohemi në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritjen e profesionalizmit të prokurorëve, fuqizimin e pavarësisë së institucionit si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.

Në mënyrë të përmbledhur drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2016 kanë qenë:

1.1 Respektimi i të drejtave të njeriut

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka patur si përparësi në veprimtarinë e saj respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e këtyre të drejtave në rastin e cënimit të tyre si dhe mbrojtjen e të drejtës së pronës private dhe publike nga veprimet e paligjshme etj, duke bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera vendore dhe qendrore me qëllim hetimin e veprave penale në këtë fushë në kohë sa më të shpejtë dhe parandalimin e pasojave kriminale. Respektimi i të drejtave të ligjshme të qytetarëve dhe mbrojtja e lirive themelore të tyre duke garantuar në çdo rast procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor është detyrim kushtetues i Prokurorisë.

Të drejtat janë respektuar gjatë hetimeve paraprake dhe në mënyrë të veçantë në zbatimin e kushteve dhe kriterëve ligjore në kërkimet për caktimin e masave të sigurimit dhe të dënimit, duke u nisur nga parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

1.2 Të miturit dhe grupet vulnerabël si të pandehur dhe viktima

Një kujdes i veçantë i është kushtuar të miturve dhe grupeve të tjera vulnerabël në kërkimet alternative në Gjykatë. Kështu ndaj tyre është rritur kërkesa e prokurorëve për masa sigurimi alternative ndryshe nga ajo e arrestit në burg dhe menjëherë aktet i janë dërguar për hetime të mëtejshme prokurorisë kompetente në rastin e të miturve. Është siguruar pjesëmarrja e psikologut dhe e mbrojtësit në rastet e arrestimeve dhe veprimeve të para me të mitur, për të respektuar maksimalisht të drejtat e tyre në procesin penal. Janë njoftuar prindërit dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, në respektim të ligjit dhe zbatimi i parimit të interesit më të lartë të të miturit.

Lidhur me caktimin e masave të sigurimit për të pandehurit e mitur 14 deri në 18 vjeç gjatë vitit 2016 rezulton se gjatë këtij viti është kërkuar për 1 të arrestuar të mitur caktimi i masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe për 3 prej tyre masa e sigurimit “Arrest në burg” duke patur parasysh këtu kriteret ligjore, si faktin se ndonjë prej tyre ka qenë përsëritës, faktin se nga ana e tyre janë kryer vepra të rënda penale, etj. Ndërsa për vitin 2015 nuk kemi patur raste të arrestimit të të miturve. Të njëjtave raporte në përgjithësi u ka qëndruar edhe Gjykata.

Në mënyrë të veçantë prioritet ka qenë dhe rritja e efektivitetit të hetimit të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve, martesës dhe familjes. Përhapje të madhe ka patur vepra penale e “Dhunës në familje”. Në vitin 2016 janë regjistruar 29 çështje për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal me të gjithë paragrafët e saj. Nga këto, 25 çështje me 25

të pandehur janë dërguar për gjykim. Ndërsa 4 prej tyre janë pushuar për shkaqe të ndryshme. Siç konstatohet, këto çështje janë hetuar me përkushtim e përparësi nisur nga vetë natyra e veprës penale.

1.3 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Raporti me Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës

Gjatë vitit 2016, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë disa urdhëra dhe udhëzime, zbatimi i të cilëve ka qenë në fokus të prokurorëve me qëllim mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe zbatimin korrekt të ligjit penal procedural. Këto urdhëra dhe udhëzime janë punuar edhe me oficerë të policisë gjyqësore.

Raporti me Drejtoritë Përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për vitin 2016 bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme ka qenë korrekt. U jemi përgjigjur në kohë kërkesave të tyre për çështje të ndryshme. Një bashkëpunim intensiv kemi patur dhe me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë për rastet e ekstradimeve, njohjes së vendimeve penale të huaja dhe ekzekutimit të letër-porosive të ardhura nga jashtë shtetit. Kështu ka patur 17 kërkesa të ekzekutimit të letër porosive nga jashtë shtetit, me objekte të ndryshme, si kryerjen e veprimeve hetimore të kërkuara, njoftimin e shtetasve të ndryshëm për vendimet e dhëna ndaj tyre nga gjykatat e vendeve të tjera dhe 8 kërkesa për njohje vendimi penal të huaj.


Raporti me Strukturat e Policisë Vendore

Bashkëpunimi me Komisariatin e Policisë Kurbin dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë ka qenë shumë i ngushtë për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin e tyre, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimin e tyre sipas ligjit me qëllim parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Numri i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të policisë vendore. Kështu nga 817 kallëzime në total të regjistruara për vitin 2016, peshën më të madhe të referimeve (85%) e zënë referimet e kryera nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë. Nga keto kallëzime 795 pasqyruar ne te dhenat statistikore sipas grup veprave perkatese, rezulton se 22 materilae kallezueze pa kualifikim ligjore jan relatuar per vleresim , si largim nga bandesa, mbytje etj. 1Më tej janë kryer 93 kallëzime nga shtetasit, 5 nga nëpunësit publikë, 1 referim i kryer kryesisht dhe 3 me ankim. Një kujdes i veçantë i është kushtuar dhënies së udhëzimeve dhe detyrave për oficerët e policisë gjyqësore në strukturat e policisë së shtetit, që janë deleguar për hetimin e çështjeve penale të referuara nga ana e tyre. Gjithashtu ata janë njohur edhe me kuadrin ligjor të ndryshuar të ligjit penal-procedural.

Grafiku vijues pasqyron numrin e kallëzimeve me referuesit kryesorë të veprave penale.

¹ Nga keto kallëzime, 795 pasqyruar ne te dhenat statistikore sipas grup veprave perkatese, dhe se 22 materiale kallezueze jane referuar pa kualifikim ligjore, per vleresim , si largim nga bandesa, mbytje etj gjithsej 817



Lidhur me referimet që policia e shtetit sjell për fakte dhe ngjarje të kallëzuara nga shtetas të ndryshëm, vlerësojmë se është e nevojshme që kallëzimet e shtetasve të referohen në Prokurori pasi të plotësohen me veprimet e nevojshme hetimore dhe procedurale. Këtë problem e kemi diskutuar rast pas rasti në takimet me drejtuesit e strukturave të policisë gjyqësore dhe me oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Kurbin, duke sugjeruar plotësimin me veprimet e nevojshme të materialit para se ai të referohet në prokurori. Plotësimi me veprimet e nevojshme hetimore i materialit që referohet në prokurori, **së pari**: është detyrim procedural për oficerin e policisë gjyqësore pasi ai duhet të konkludojë dhe të krijojë bindje se fakti që kallëzohet ka ndodhur, **dhe së dyti**: materiali i plotësuar me veprimet e nevojshme hetimore i jep mundësi prokurorit të konkludojë me zgjidhje të shpejtë ligjore, siç është ajo e mosfillimit në rastet kur rezultojnë kushtet ligjore për këtë zgjidhje, apo të regjistrojë menjëherë procedimin dhe të orientojë shpejt kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore. Në këtë mënyrë do të shmangeshin zvarritjet e panevojshme në trajtimin e materialeve të referuara dhe në dhënien e zgjidhjeve ligjore të shpejta dhe të bazuara në ligj dhe në prova.

Raporti me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin

Bashkëpunimi me Gjykatën ka qenë korrekt dhe i mbështetur në pavarësinë e secilit organ publik. Prokurorët kanë qenë korrekt me paraqitjen e tyre në seancat gjyqësore si përsa i përket etikës ashtu edhe përfaqësimit të çështjeve. Nuk ka patur raste të evidentuara nga ndonjë gjyqtar në lidhje me sjelljen, etikën, paraqitjen apo përfaqësimin e akuzës nga ana e prokurorëve në Gjykatë. Është koordinuar puna në rastet e trajnimit të përbashkët të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Raporti me institucionet e tjera

Një bashkëpunim reciprok ka patur edhe me institucionet e tjera vendore dhe qendrore, si me Zyrën Përmbare, Zyrën e Shërbimit të Provës Lezhë, IEVP Lezhë, etj për nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit të vendimeve penale nga ana e prokurorit, për mbikqyrjen në vazhdimësi të ekzekutimit dhe zbatimit të dënimeve penale, kohën e provës, etj. Vetëm për vitin 2016 janë nxjerrë 183 urdhëra ekzekutimi, nga të cilat 98 urdhëra ekzekutimi me burgim, 34 urdhëra ekzekutimi me gjobë, 5 urdhëra ekzekutimi me dënime plotësuese, 45 urdhëra ekzekutimi me dënime me kusht dhe 1 urdhër ekzekutimi për aplikim të nenit 63 për kryerjen e një pune në interes publik. Statistikat mbi konkretizimin e urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga prokurori konkludojnë në: ekzekutimin e 83 urdhër ekzekutimeve për dënime me burg, 34 urdhër ekzekutime për dënime me gjobë, 1 urdhër ekzekutim në referencë të nenit 59 dhe 1 urdhër ekzekutim në referencë të nenit

63 për kryerjen e një pune në interes publik. Në total janë ekzekutuar 119 vendime dhe mbeten për ekzekutim dhe 64 vendime të tjera.

Institucionet e tjera kanë qenë bashkëpunuese, duke u kthyer përgjigje në kohë kërkesave të organit të prokurorisë së funksion të hetimit të procedimeve penale, etj. Janë organizuar takime me faktorët e tjerë për sensibilizimin e opinionit për të dhënë ndihmën e duhur në parandalimin e veprave penale në marrëdhëniet familjare, në ndikimin pozitiv të grupeve vulnerabël, sidomos të miturve për të mos kryer vepra penale, etj.

1.4 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore ndërkombëtare është arritur nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Siç u përmend dhe më sipër, prokurorët kanë qenë korrektë dhe të shpejtë në ekzekutimin e letër-kërkesave të ndryshme të autoriteteve të huaja gjyqësore, si në njoftimin e dëshmitarëve, njoftimin e të pandehurve, njoftimin e vendimeve penale të gjykatave të huaja, etj. Janë ekzekutuar gjithsej 17 kërkesa për letërporosi gjatë vitit 2016 dhe 10 kërkesa për njohje vendimesh të huaja dhe janë lëshuar 4 urdhra kërkimi ndërkombëtar

1.5 Përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proaktive

Gjatë vitit 2016, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin janë evidentuar disa raste të përdorimit të teknikave të posaçme të hetimit sipas Kodit të Procedurave Penale në referim të neneve 294/a dhe 294/b, veprimet stimuluese dhe agentët e infiltruar. Në disa çështje janë kryer përgjime të telekomunikimeve dhe në disa prej tyre ka patur rezultate të mira në interes të hetimit. Në të ardhmen mendojmë se do të intensifikohet puna në drejtim të përdorimit të këtyre metodave speciale të hetimit, duke qenë se krimi i organizuar dhe krimi në përgjithësi po avancon dhe po bëhet më konspirativ.

1.6 Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre

Krahasuar me vitin 2015, gjendja e kriminalitetit për veprat e rënda penale si vrasjet, vjedhjet me armë, trafiket e paligjshme, rastet e shpërdorimit të detyrës, korrupsionit, etj ka shënuar një tendencë disi në rënie, por që ende shprehet me tregues të lartë.

Natyrisht që në tendencën në rënie të veprave penale, rol të rëndësishëm ka luajtur dhe respektimi i rekomandimeve të përvitshme të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit dhe krimin të organizuar si dhe urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm. Duke patur parasysh sa më sipër, organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka punuar me profesionalizëm, përkushtim e korrektësi ligjore për të përmbushur me sukses detyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq, mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyra të tjera që ligji i ngarkon asaj.

1.7 Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike

Gjatë vitit 2016, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin është regjistruar një procedim penal që lidhet me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike, sipas ligjit nr.138/2015, i cili i është dërguar gjykatës për gjykim (rasti R.Toma) dhe është deklaruar fajtor.

1.8 Problematikat e ndeshura

Një problematikë e evidentuar në raport me Policinë, pra shërbimet e Policisë Gjyqësore janë lëvizjet e shpeshta të oficerëve. Ka raste të zëvendësimit në një procedim penal të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Kjo për shkak të lëvizjeve të shpeshta nga një sektor në tjetrin, ka raste që dosjet janë sjellë në prokurori pas një muaji nga lëvizjet, pa relacion, etj. Materiale procedurale të referuara jashtë afatit 5 ditor në rastet kur nuk ka materiale të sekuestruara dhe jashtë afatit 2 ditor në rastet kur kemi materiale të sekuestruara.

Janë të shpeshta rastet kur nuk respektohet afati i lënë nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, ku në lidhje me këtë problematikë është kërkuar rritja e kontrollit nga drejtuesit e seksioneve. Ajo që duhet evidentuar si mangësi është mos trajtimi i rasteve të shkeljeve duke kaluar në procedim disiplinor oficerët e policisë gjyqësore. Gjatë dinamikës së punës në hetimin e çështjeve shpesh evidentojmë të meta dhe mangësi, që janë trajtuar duke tërhequr vëmendjen.

II- ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2016

2.1 Volumi i punës në hetim për vitin 2016

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, gjatë vitit 2016 janë trajtuar 817 materiale kallëzuese/referuese që përbën një rritje prej 6.7% në krahasim me vitin 2015 gjatë të cilit janë regjistruar 763 materiale kallëzuese/referuese. Janë ndjekur gjithsej 652 procedime penale, 57 procedime më pak se në vitin 2015, në të cilin janë ndjekur 709 procedime penale. Janë mbartur nga viti 2016 dhe nga vitet e kaluara 79 procedime, nga 147 procedime penale që ishin mbartur për vitin 2016 nga viti 2015 dhe vitet e kaluara.²


Nga 817 materiale kallëzuese është vendosur mosfillimi për 254 referime dhe kallëzime penale të vitit 2016 krahasuar me 320 referime dhe kallëzime të mosfilluara gjatë vitit 2015.

Volumi i punës në hetim i organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për vitin 2016 paraqitet si vijon:

Lloji i Procedimeve Penale	Numri i procedimeve	Persona nën hetim	Të pandehur	Të arrestuar
Procedime të mbartura nga 2015	147	1	62	17
Procedime penale të regjistruara	505	62	209	108
Rifilluar të pushuara	0	0	0	0
Rifilluar të pezulluara	0	0	0	0
Ardhur me transferim	4	1	4	3
TOTALI	652	63	275	128

Krahasimi i statistikave të dy viteve të fundit

Vitet	Kallëzime të regjistruara	Procedime të mbartura	Procedime të regjistruara	Rifilluar/ Transferuar	Ndjekur procedurat në hetim
2015	763	200	502	4/8	709
2016	817	147	501	4	652



² Janë ndjekur gjithsej 652 procedime penale, nga te cilat 501 rishtazi nga Prokuroria Kurbin 4 te ardhura nga Prokurori te tjerë gjithsej 505 sebashku me 147 te mbartura gjitsej 652

Nga 652 procedime të vitit 2016 u është dhënë zgjidhje 573 procedimeve me 35 persona nën hetim, me 272 të pandehur dhe 114 të arrestuar, si vijon:

- **Pushime:** 83 procedime penale me 18 persona nën hetim janë pushuar krahasuar me 95 procedime penale me 27 persona nën hetim të pushuara gjatë vitit 2015.
- **Pezullime:** 220 procedime janë pezulluar për shkak se pas hetimit të kryer për këto procedime penale nuk është bërë e mundur të identifikohen autorët e veprave penale. Krahasuar me një vit më parë, kjo zgjidhje ligjore është vendosur për 81 procedime penale më shumë, pasi gjatë vitit 2015 pezullimi i hetimeve është vendosur për 139 procedime penale.
- **Transferime:** Për 27 procedime penale me 17 persona nën hetim dhe 7 të arrestuar, prokurorët kanë konstatuar moskompetencën për hetimin e tyre prandaj dhe kanë vendosur transferimin në prokuroritë e tjera. Procedimet me të mitur zënë numrin më të madh të procedimeve të transferuara për shkak të kompetencës për ndjekjen e tyre nga Seksioni për të mitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- **Gjykime:** Gjatë vitit 2016, prokurorët kanë vendosur dërgimin në gjykatë për 243 procedime me 272 të pandehur dhe 107 të arrestuar kundrejt 232 procedimeve penale të dërguara në gjykatë gjatë vitit 2015 me 250 të pandehur dhe 64 të arrestuar.

Mbeten në hetim për vitin 2017

- 79 procedime me 28 persona nën hetim nga të cilët 14 të arrestuar.

Janë gjykuar gjatë vitit 2016

- 244 procedime me 265 të pandehur nga të cilët 92 me arrest në burg
- mbeten në gjykim 77 procedime me 92 të pandehur, nga të cilët 24 me arrest në burg

2.2 Çështje të përfaqësuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin

Gjatë vitit 2016 nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin është ngritur dhe përfaqësuar akuza në Gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 321 procedime penale me 357 të pandehur, 116 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”. Krahasuar me vitin 2015, gjatë të cilit u përfaqësuan në Gjykatë 360 procedime penale me 104 të pandehur, 111 prej të cilëve me masën e sigurisë “Arrest në burg” rezultojnë 39 çështje më pak.

Janë gjykuar gjithsej gjatë vitit 2016 saktësisht 244 çështje penale me 265 të pandehur, 92 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërkohë gjatë vitit 2015 janë gjykuar 253 çështje penale me 276 të pandehur, 76 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Gjithashtu janë paraqitur në Gjykatë 212 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal, nga të cilat 158 prej tyre me “Arrest në burg”, 9 me “Arrest në burg në mungesë”, 7 me “Arrest në shtëpi”, 11 “Arrest në burg me afat” dhe 27 me “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë për vitin 2016

Procedime penale të regjistruara

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 janë regjistruar rishtazi 501 procedime penale, krahasuar me 496 çështje të regjistruara në vitin 2015, fakt i cili tregon se gjendja e kriminalitetit ka qenë pak a shumë e njëjtë. Ndërsa ishin mbartur në total për vitin 2016, 147 çështje penale përshtirë dhe çështje të viteve të kaluara krahasuar me 200 çështje të mbartura gjatë vitit 2015.

Mosfillimet

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016, është vendosur mosfillimi për 254 referime dhe kallëzime penale të vitit 2016 nga 320 të vitit 2015. (Sqarojmë se nga të dhënat statistikore rezultojnë gjithsej 226 mosfillime). Ky tregues shpjegohet ndër të tjera me faktin se ndodhemi para veprave penale, të cilat ndiqen me ankim, për të cilat prokuroria nuk është organi i ndjekjes penale. Theksojmë se 28 raste të mosfillimeve kanë qenë të pa hedhura hedhur ende në statistikat elektronike, pasi kanë qenë materiale për vlerësim.³

Duke iu referuar statistikës për grup, veprat penale për të cilat është vendosur mosfillimi rezultojnë si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit të parashikuara nga nenet 76-133 të Kodit Penal është vendosur mosfillimi për 124 referime gjatë vitit 2016, kundrejt 93 referimeve gjatë vitit 2015.
- Për veprat penale kundër pasurisë të parashikuara nga nenet 134-200 të Kodit Penal është vendosur mosfillimi për 113 referime gjatë vitit 2016, kundrejt 63 referimeve gjatë vitit 2015.
- Për veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara në nenet 283-326 të Kodit Penal është vendosur mosfillimi për 37 referime kundrejt 27 referimeve gjatë vitit 2015.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin janë prishur dhe këto vendime mosfillimi:

- Vendim i Gjykatës Kurbin Nr.80-25, datë 28.01.2016 për pranimin e ankimit kundër vendimit të mosfillimit nga Prokuroria Kurbin në emër të Rrok Hotit
- Vendim i Gjykatës Kurbin Nr.826-178, datë 15.07.2016 për pranimin e ankimit kundër vendimit të mosfillimit nga Prokuroria Kurbin në emër të Prena Trycit
- Vendim i Gjykatës Kurbin Nr.1024-219, datë 30.09.2016 për pranimin e ankimit kundër vendimit të mosfillimit nga Prokuroria Kurbin në emër të Valentin Gjinaj
- Vendim i Gjykatës Kurbin Nr.1408-275, datë 22.12.2016 për pranimin e ankimit kundër vendimit të mosfillimit nga Prokuroria Kurbin në emër të Ded Guri

³ është vendosur mosfillimi për 254 referime dhe kallëzime penale të vitit 2016 nga 320 të vitit 2015. (Sqarojmë se nga të dhënat statistikore rezultojnë gjithsej 226 mosfillime). Ky tregues shpjegohet ndër të tjera me faktin se ndodhemi para veprave penale, të cilat ndiqen me ankim, për të cilat prokuroria nuk është organi i ndjekjes penale. Theksojmë se 28 raste të mosfillimeve kanë qenë të pa hedhura hedhur ende në statistikat elektronike, pasi kanë qenë materiale për vlerësim.

Pushimet e çështjeve

Gjatë vitit 2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin është vendosur pushimi për 83 procedime penale, 12 çështje më pak krahasuar me vitin 2015 gjatë të cilit u vendos pushimi për 95 procedime penale. Në të gjitha këto procedime penale përgjithësisht janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzimitarëve, institucioneve, apo individëve dhe palëve të interesuara.

Duke iu referuar statistikës për grup, veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi rezulton se është vendosur pushimi si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit të parashikuara nga nenet 76-133 të Kodit Penal janë pushuar 13 çështje gjatë vitit 2016, kundrejt 19 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2015.
- Për veprat penale kundër pasurisë të parashikuara nga nenet 134-200 të Kodit Penal janë pushuar 37 çështje gjatë vitit 2016, kundrejt përsëri 37 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2015.
- Për veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara në nenet 283-326 të Kodit Penal janë pushuar 17 çështje kundrejt 14 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2015.

Procedimet penale të pezulluara

Është vendosur pezullimi i hetimeve në bazë të nenit 326 të Kodit të Procedurave Penale për 220 procedime penale, 13 procedime më shumë se në vitin 2015 gjatë të cilit janë pezulluar 207 procedime penale. Evidenca e pezullimeve të procedimeve penale e ndarë sipas grup veprave është si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit të parashikuara nga nenet 76-133 të Kodit Penal janë pezulluar 4 procedime penale gjatë vitit 2016, kundrejt 5 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2015.
- Për veprat penale kundër pasurisë të parashikuara nga nenet 134-200 të Kodit Penal janë pezulluar 145 procedime penale gjatë vitit 2016, kundrejt 173 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2015.
- Për veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara në nenet 283-326 të Kodit Penal janë pezulluar 71 procedime penale gjatë vitit 2016, kundrejt 29 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2015.

Siç vihet re, procedimet penale të pezulluara që zënë peshën më të madhe janë procedimet e veprave penale kundër pasurisë. Këto procedime janë kryesisht me vendngjarje të referuara nga seksionet e Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit Kurbin dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë. Në të gjitha rastet është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore, si dhe janë deleguar veprime të posaçme dhe në përfundim bazuar dhe në relacionin e oficerëve të policisë gjyqësore është vendosur pezullimi i hetimeve.

Për pjesën tjetër të procedimeve është vendosur pezullimi i hetimeve për veprat penale në fushën e shkatërrimit të pronës, etj. Në asnjë rast nuk është vendosur pezullimi i hetimeve, me autorë të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Rritja e numrit të procedimeve penale të pezulluara ka ardhur si rezultat i marrjes së vendimeve për pezullimin e hetimeve edhe për procedimet penale që kanë qenë të mbartura në vite e të regjistruara më së shumti për veprën penale të “vjedhjes” pa autor.

Krimi pa autor shoqërohet me impakt të rëndë shoqëror, ai përcjell mosbesim tek organet e rendit dhe të ndjekjes penale, si dhe pasiguri sociale për jetën dhe pronën. Me këtë vlerësim duhet gjykuar treguesi i pezullimit të hetimeve të vendosura gjatë vitit 2016 me 220 procedime penale të pezulluara, kundrejt 207 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2015.

Rritja e zbulueshmërisë së autorëve të veprave penale kërkon përmirësimin e punës me procedimet penale pa autor. Nga prokurorët kërkohet që të orientojnë më mirë dhe më drejt hetimin, duke përcaktuar detyra dhe veprime konkrete, duke ndjekur edhe vetë disa prej veprimeve që kërkojnë njohuri dhe profesionalizëm, si dhe duke aplikuar më shumë hetime proaktive.

Por, natyrisht që rritja e zbulueshmërisë kërkon edhe angazhim më të mirë të strukturave të policisë gjyqësore që janë në terren, që të ushqejnë hetimin me të dhëna dhe fakte në vijimësi dhe të mos ngelen vetëm në kuadrin e të dhënave të siguruara nga veprimet e para hetimore.

Procedimet penale të transferuara

Është vendosur transferimi për kompetencë për 27 procedime penale, ndër të cilat pjesa dërrmuese i është transferuar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksionit të të Miturve. Nga 27 procedime penale të transferuara gjatë vitit 2016, 17 persona janë nën hetim, ku 7 prej tyre me masën e sigurimit “arrest me burg”. Ndërkohë e njëjta statistikë rezulton dhe për vitin 2015 gjatë të cilit janë regjistruar 27 procedime penale të transferuara, për të cilat 27 persona nën hetim, ku 9 prej tyre me masën e sigurimit “arrest në burg”.

Në asnjë rast të shpalljes së moskompetencës dhe kalimit të akteve Prokurorisë kompetente nuk kemi patur konflikt për zgjidhjen e kompetencës.

Çështjet penale të dërguara për gjykim për vitin 2016

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin 243 çështje me 272 të pandehur, 116 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”. Krahasuar me vitin 2015, gjatë të cilit u dërguan në Gjykatë 360 procedime penale me 401 të pandehur, 111 prej të cilëve me masën e sigurisë “Arrest në burg” rezultojnë 39 çështje më pak.

Duke iu referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar dhe dërguar për gjykim të pandehurit, statistikat e detajuara rezultojnë si vijon:

- Për veprën penale **të vrasjes** të parashikuar nga nenet 76 dhe 76/22 të Kodit Penal janë dërguar në Gjykatë 3 procedime penale gjatë vitit 2016, me 3 të pandehur dhe 3 të arrestuar, kundrejt 2 procedimeve penale të dërguara gjatë vitit 2015.


- Për veprën penale të **vrasjes në rrethana të tjera cilësuese** në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave të parashikuar nga neni 79/ë i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë 1 procedim penal gjatë vitit 2016 me 4 të pandehur dhe 3 të arrestuar, kundrejt asnjë rasti të tillë gjatë vitit 2015.
- Për veprën penale të **kanosjes për gjakmarrje** të parashikuar nga neni 83/a i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë 1 procedim penal gjatë vitit 2016, i cili është pushuar për shkak të mungesës së fakteve, kundrejt asnjë rasti të tillë të konstatuar gjatë vitit 2015.
- Për veprën penale të **vjedhjes** të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal janë regjistruar 124 procedime penale dhe 29 të mbartura. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pushimin e 4 procedimeve penale, pezullimin e 123 procedimeve penale, transferimin e 3 procedimeve penale dhe dërgimin në gjyq për 5 procedime. Viti 2015 shënon 32 procedime penale.
- Për veprën penale të **vjedhjes së energjisë elektrike** të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal janë regjistruar 23 procedime penale dhe 2 të mbartura. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pushimin e 4 procedimeve penale, pezullimin e 1 procedimi penal, transferimin e 1 procedimi penal dhe dërgimin në Gjykatë për 19 procedime, kundrejt 9 procedimeve penale të dërguara gjatë vitit 2015.
- Për veprën penale të **vjedhjes me dhunë** të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal janë regjistruar 3 procedime penale të cilat janë ende nën hetim, kundrejt 11 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015.
- Për veprën penale të **vjedhjes me armë** të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal janë regjistruar 2 procedime penale. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pezullimin e 1 procedimi penal, dhe dërgimin në Gjykatë për 1 procedim penal me 2 të pandehur dhe 2 persona me arrest në burg. Viti 2015 shënon 4 procedime penale për këtë vepër krimi.
- Për veprën penale të **mashtimit** të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale dhe 5 të mbartura. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pushimin e 3 procedimeve penale, dhe dërgimin në Gjykatë për 5 procedime penale. Viti 2015 shënon 7 procedime penale.
- Për veprën penale të **ndërtimit të paligjshëm** të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal janë regjistruar 21 procedime penale dhe 4 të mbartura, kundrejt 24 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pushimin e 3 procedimeve penale, dhe dërgimin në Gjykatë për 15 procedime penale me 15 persona të pandehur.
- Për veprën penale të **prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit** të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal janë regjistruar 20 procedime të reja penale dhe 7 të mbartura, kundrejt 25 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pezullimin e 8 procedimeve penale, dhe dërgimin në Gjykatë për 17 procedime penale me 23 persona të pandehur dhe 12 të arrestuar.
- Për veprën penale të **prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta** të parashikuar nga nenet 279/a dhe 279/b i Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, kundrejt 2 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar me dërgimin në Gjykatë për të 4 procedimet penale.

- Për veprën penale të **prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive** parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal janë regjistruar 2 procedime penale. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar me dërgimin në Gjykatë për të 2 procedimet penale.
- Për veprën penale të **shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor** parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal janë regjistruar 30 procedime të reja penale dhe 10 të mbartura, kundrejt 28 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në pushimin e 13 procedimeve penale, pezullimin e 2 procedimeve penale dhe dërgimin në Gjykatë për 20 procedime penale me 20 persona të pandehur nga të cilët 7 të arrestuar.
- Për veprën penale të **drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt** parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal janë regjistruar 45 procedime të reja penale dhe 2 të mbartura, kundrejt 31 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015. Zgjidhja e rasteve ka konkluduar në transferimin e 3 procedimeve penale dhe dërgimin në Gjykatë për 44 procedime penale me 44 persona të pandehur nga të cilët 28 të arrestuar dhe 27 prej tyre me gjykim të drejtëpërdrejtë.

Pjesën më e madhe të këtyre veprave penale e përbëjnë veprat penale të vjedhjes me 152 procedime të reja penale të regjistruara dhe 31 të mbartura. Me shqetësim duhet parë jo vetëm numri i madh dhe në rritje i kësaj vepre penale, por edhe figura e kësaj vepre penale që kohët e fundit është bërë mjaft e larmishme për nga objekti material. Gjatë vitit 2015 është regjistruar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale me objekt vjedhjen e bagëtive, kryesisht lopë dhe viça duke prishur muret e stallave ku fshatarët i mbanin ato. Numri i procedimeve penale të pezulluara për moszbulim të autorit të veprës penale vazhdon të jetë shumë i lartë dhe të rritet nga viti në vit, bashkë me rritjen e numrit të procedimeve që regjistrohen për këtë vepër.

Por, ndërsa vjedhja është krimi me përhapje më të madhe dhe me tendencë rritje, zbulueshmëria e autorëve të kësaj vepre penale është mjaft e ulët. Për këtë vepër nuk rezulton të ketë pushim procedimi, apo pushim të hetimeve të personave nën hetim. Përgjithësisht, procedimet për këtë vepër penale relatohen në Prokurori pa autor, apo pa dyshime konkrete për autorë të mundshëm. Edhe nga hetimi më pas nuk sigurohen të dhëna për autorët e veprave penale, dhe në përfundim të hetimeve, relatohet pezullimi i procedimeve penale për moszbulim të autorëve.

Grafiku vijues jep një përmbledhje të këtyre treguesve vetëm për vitet 2015 dhe 2016 në shqyrtim.



Në mënyrë të përmbledhur treguesit e veprave penale janë si në tabelë:

VITI	134	137	197	199/a	278	290	291	76-83	139,40	130/a
2013	103	-	14	16	13	27	30	10	6	16
2014	140	12	19	23	24	19	61	11	12	48
2015	146	7	23	24	25	28	31	6	12	24
2016	153	25	4	25	27	40	47	5	5	23

2.4 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale

Gjatë vitit 2016, të dhënat në lidhje me njoftimet e veprave penale paraqiten si më poshtë: Nga nëpunësit publikë janë depozituar 5 kallëzime penale. Nga shtetasit janë depozituar 93 kallëzime penale. Një kallëzim është i kryer kryesisht dhe 3 me ankime. Nga Komisariati i Policisë Kurbin janë depozituar 426 kallëzime me vendngjarje dhe 266 kallëzime të tjera. Siç shihet numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të policisë vendore. Kështu nga 817 kallëzime në total të regjistruara për vitin 2016, peshën më të madhe të referimeve (85%) e zënë referimet e kryera nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Kurbin me 692 referime të veprave penale.


2.5 Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror

Nga ana Prokurorisë është kërkuar caktim mase sigurimi shtrënguese ndaj 212 personave, ku për 158 persona është kërkuar masa e sigurisë “Arrest në burg” sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale; për 7 persona masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” sipas nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale; për 9 persona “Arrest në burg në mungesë”; për 11 persona “Arrest në burg me afat”; dhe për 27 persona “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” sipas nenit 234 të Kodit të Procedurave Penale.

Nga ana e Gjykatës është vendosur për 128 persona masa e sigurimit “Arrest në burg”; për 10 persona “Arrest në burg në mungesë”; për 21 persona “Arrest në shtëpi”; për 14 persona “Arrest në burg me afat”; si dhe për 39 persona masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Tabela dhe grafiku vijues paraqesin në mënyrë të përmbledhur të dhënat:

Lloji i masës	Arrest në burg	Arrest në shtëpi	Arrest në burg me afat	Në mungesë	Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore	TOTALI
Prokurori	158	7	11	9	27	212
Gjykata	128	21	14	10	39	212

Grafiku vijues na jep një panoramë më të qartë sesi kanë ndryshuar masat e sigurimit gjatë dy viteve të fundit:



2.6 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Në vitin 2016 janë ekzekutuar 190 vendime penale të formës së prerë. Nga këto:

- 49 vendime kanë patur disponim me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim
- 35 vendime kanë patur disponim me dënim me gjobë
- 102 vendime kanë patur disponim me dënim me burgim
- 9 vendime kanë patur disponim për masa mjekësore
- 45 vendime kanë patur disponim për prova materiale
- 158 vendime janë ekzekutuar për shpenzime procedurale. Ndërkohë Zyra e Përmbarrimit Kurbin ka njoftuar për ekzekutimin e 173 shpenzimeve procedurale, duke përfshirë këtu dhe shpenzime procedurale të viteve të mëparshme.

Gjithashtu janë pushuar për efekt të amnistisë së vitit 2015 rreth 98 ekzekutime dhe janë ekzekutuar rreth 390 gjoba penale që u përkasin dhe viteve të mëparshme. Janë nxjerrë 4 urdhra kërkimi ndërkombëtar.

Viti	URDHËRA EKZEKUTIMI						
	Burg	Gjobë	Neni 59	Neni 63	Masa mjekësore	Shpenzime procedurale	Prova Materiale
2016	102	35	49	0	9	158	45
TOTALI	190						

2.7 Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin

Sa i përket shtrirjes territoriale, kriminaliteti ka patur tendencë të shtrirjes në njësitë administrative të Bashkisë Kurbin, bazuar në materialet e referuara nga Komisariati i Policisë Kurbin. Kjo vjen si rezultat i gjendjes social-ekonomike të banorëve të kësaj njësie, papunësisë së lartë, prurjeve të reja demografike nga zonat verilindore të Shqipërisë, të cilat janë zhvendosur në Rrethin e Kurbin për kushte më të mira jetese, duke mos patur mundësinë për t'u vendosur në Tiranë. Prurjet e reja kanë

sjellë së bashku me problemet ekonomike dhe sociale dhe tendencën në rritje të treguesve të kriminalitetit.

2.8 Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre

Në lidhje me tendencën e kriminalitetit, të përhapjes së veprave penale në përgjithësi, apo me grup veprash penale të veçanta rezulton se veprat penale me një shtrirje dhe përhapje më të madhe janë ato kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike me 285 procedime penale.

Evidentojmë se për nenet 134/1/2-142 të Kodit Penal janë regjistruar 193 procedime penale; për nenet 143-149 të Kodit Penal janë regjistruar 9 procedime penale, kundrejt 13 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 150-162 të Kodit Penal janë regjistruar 12 procedime penale, kundrejt 17 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 171-179/b të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal; për nenet 180-182 të Kodit Penal janë regjistruar 9 procedime penale, kundrejt 15 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 183-185 të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, kundrejt 2 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 186-196 të Kodit Penal janë regjistruar 24 procedime penale, kundrejt 27 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 197-198 të Kodit Penal janë regjistruar 8 procedime penale, kundrejt 28 të regjistruara në vitin 2015 dhe për nenet 199-200 të Kodit Penal janë regjistruar 28 procedime penale, kundrejt 40 të regjistruara në vitin 2015.

Pas këtij evidentimi duhen përmendur veprat penale që kanë të bëjnë me krime kundër autoritetit të shtetit, respektivisht 281 procedime penale të detajuara si vijon: për nenet 235-247 të Kodit Penal janë regjistruar 9 procedime penale, kundrejt 11 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 248-260 të Kodit Penal janë regjistruar 12 procedime penale, kundrejt 10 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 261-293/c të Kodit Penal janë regjistruar 259 procedime penale, kundrejt 197 të regjistruara në vitin 2015 dhe për nenet 294-299 të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal njësoj si në vitin 2015.

Veprat penale të drejtuara kundër shëndetit dhe jetës së personit. Rezulton se për vitin 2016 janë regjistruar 72 procedime penale, 16 procedime më pak se viti 2015. Për nenet 76-84/a të Kodit Penal janë regjistruar 16 procedime penale, kundrejt 34 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 86-90 të Kodit Penal janë regjistruar 12 procedime penale, kundrejt 10 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 93-99 të Kodit Penal janë regjistruar 3 procedime penale, kundrejt 4 të regjistruara në vitin 2015; për nenet 100-108 të Kodit Penal nuk është regjistruar asnjë procedim penal, kundrejt 1 të regjistruar në vitin 2015; për nenet 109-112/2 të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal njësoj si në vitin 2015; për nenet 113-123 të Kodit Penal janë regjistruar 5 procedime penale njësoj si në vitin 2015; për nenet 124-130/a/4 të Kodit Penal janë regjistruar 35 procedime penale kundrejt 33 të regjistruara në vitin 2015.

Një tendencë në rritje të kriminalitetit ka patur kryerja e veprave penale kundër mjedisit të parashikuar nga nenet 201-207 të Kodit Penal (prerje e paligjshme e pyjeve dhe shkatërrim me zjarr i pyjeve) ku evidentohen 5 raste në krahasim me një rast të evidentuar gjatë vitit 2015.

Duke iu referuar të dhënave të sipërpërmendura, vihet re se ka një tendencë në rritje të veprës penale të vjedhjes. Kështu nëse në vitin 2016 janë regjistruar 193 procedime penale me 10 persona nën hetim, 26 të pandehur dhe 13 të arrestuar, statistikat e vitit 2015 flasin për 32 procedime penale

të regjistruara me 38 persona nën hetim, 24 të pandehur dhe 1 të arrestuar. Pra kemi 161 procedime penale më shumë gjatë vitit që lamë pas, duke e bërë fenomenin e vjedhjes një fenomen mjaft problematik për zonën e Kurbin dhe që duhet të jetë në vijim në fokus të profesionistëve të kriminalistikës .

Evidentohet një rritje e çështjeve penale të regjistruara për nenin 290 të Kodit Penal (aksidenteve automobilistike), ku për vitin 2016 janë regjistruar 40 procedime penale ndaj 35 të regjistruara gjatë vitit 2015.

Problematike mbeten dhe çështjet penale që lidhen me “Drejtimin e automjetit në mënyrë të parregullt” i parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ku për vitin 2016 janë regjistruar 47 procedime penale, ndaj 34 të regjistruara gjatë vitit 2015.

Rezulton se për nenin 199/a të Kodit Penal që parashikon veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” ka një rënie të lehtë të rasteve të regjistruara. Kështu nga 29 raste të regjistruara në vitin 2015, në vitin 2016 janë regjistruar vetëm 21 raste me një person nën hetim dhe 12 të pandehur.

III- ANALIZA KRAHASIMORE 2 VJEÇARE E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

3.1 Në vitin 2016 janë regjistruar rishtazi në regjistrin e njoftimit të veprave penale gjithsej 505 procedime penale, me 62 persona nën hetim dhe 210 të pandehur nga të cilët 108 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

3.2 Ndërsa në vitin 2015 janë regjistruar rishtazi në regjistrin e njoftimit të veprave penale gjithsej 504 procedime penale me 138 persona nën hetim dhe 186 të pandehur, nga të cilët 65 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

3.3 Gjatë vitit 2016 janë hetuar gjithsej 652 procedime penale me 63 persona nën hetim dhe 275 persona të marrë si të pandehur, nga të cilët 128 me masë sigurimi “Arrest në burg”. Këtu përfshihen procedimet e mbartura, të rifilluara dhe të ardhura me transferim.

3.4 Ndërsa gjatë vitit 2015 janë hetuar gjithsej 709 procedime penale me 167 persona nën hetim dhe 253 persona të marrë si të pandehur, nga të cilët 87 me masë sigurimi “Arrest në burg”. Këtu përfshihen procedimet e mbartura, të rifilluara dhe të ardhura me transferim.

3.5 Për vitin 2016 janë dërguar për gjykim 243 çështje me 272 të pandehur, nga të cilët 107 me masë sigurimi “Arrest në burg” dhe 29 me gjykim të drejpërdrejtë.

3.6 Ndërsa në vitin 2015 janë dërguar për gjykim 232 çështje penale me 250 të pandehur, nga të cilët 64 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË KURBIN PËR VITIN 2016

4.1 Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin 321 çështje me 357 të pandehur, 116 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Gjatë vitit 2016 pas dërgimit të procedimeve penale për gjykim (përfshirë këtu edhe dosjet e mbartura në gjykim nga viti 2015) ka përfunduar gjykimi gjatë vitit 2016 për 244 procedime penale me 265 të pandehur nga të cilët 92 me “Arrest në burg”. Janë mbartur për gjykim 77 procedime penale me 92 të pandehur, 24 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”.

4.2 Të dhëna për gjykimet e posaçme

Gjatë vitit 2016, nga 209 çështje me 223 të pandehur është zhvilluar gjykim i zakonshëm për 10 procedime me 13 të pandehur, gjykim i shkurtuar për 170 procedime me 180 të pandehur dhe gjykim i drejtpërdrejtë për 29 procedime me 30 të pandehur. Gjykata ka disponuar në të njëjtën mënyrë.

VITI	GJYKIM I DREJTPËRDREJTË		GJYKIM I ZAKONSHËM		GJYKIM I SHKURTUAR		GJYKIM NË MUNGESË		SHUMA	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2016	29	30	10	13	170	180	0	0	209	223

4.3 Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve

Siç u relatua më sipër, për vitin 2016, sipas të dhënave statistikore ka përfunduar gjykimi në gjykatë për 209 çështje me 223 të pandehur. Në varësi të llojit të veprave penale, sanksioneve përkatëse, rrezikshmërisë së tyre dhe të pandehurve, shkallës së fajit dhe rrethanave lehtësuese e rënduese janë bërë dhe kërkimet e prokurorit për llojin dhe masat e dënimit.

Nga Prokurori është kërkuar: Dënim me burgim për 200 të pandehur, nga të cilët vetëm për 17 të pandehur në kufijtë pranë minimumit të dënimit, 162 të pandehur në kufijtë mesatarë të dënimit, për një të pandehur në kufirin maksimal të dënimit, ndërsa për 20 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim (referuar nenit 59 të Kodit Penal).

Dënimi me gjobë është kërkuar për 35 të pandehur, që në më të shumtën e rasteve kanë qenë rastet e mashtrimit në sigurime për përfitime të pensioneve, apo trajtimeve të veçanta të paligjshme.

Është kërkuar tërheqja e akteve për një rast procedimi penal për vepra jo të rënda.

Nga ana e Gjykatës në lidhje me kërkesat e bëra nga Prokuroria që parashtruan më sipër është vendosur deklarimi fajtor për 193 të pandehur (nga 200 të kërkuara nga Prokuroria).

Nga Gjykata është vendosur: Dënimi me burgim për 193 të pandehur nga të cilët 28 të pandehur në kufijtë e minimumit të dënimit, 100 të pandehur në kufijtë e dënimit mesatar, asnjë në kufijtë

maksimalë të dënimit, 4 të pandehur nën kufijtë e parashikuar nga ligji dhe për 61 të pandehur ka aplikuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim (referuar nenit 59 të Kodit Penal).

Dënimi me gjobë është dhënë për 36 të pandehur (nga 35 të kërkuar nga Prokurori). Në një rast të vetëm që është kërkuar kthimi i akteve nga organi i akuzës, kjo nuk është aprovuar nga Gjykata. Gjatë vitit 2016 Gjykata ka deklaruar të pafajshëm 6 të pandehur dhe në 9 raste ka vendosur pushimin e çështjes. Numri i pafajësive të dhëna gjatë vitit 2015 është 1 rast i vetëm. Kemi një rritje me 6 herë të numrit të pafajësive të dhëna gjatë vitit 2016.

Krahasuar me vitin 2015, konstatohet një rënie e lehtë e numrit të procedimeve të gjykuara, më konkretisht për vitin 2016 krahasuar me një vit më parë janë gjykuar 243 procedime penale me 265 të pandehur, kundrejt 253 procedimeve penale me 276 të pandehur të përfunduara gjatë vitit 2015. Pra, në tërësi 8 procedime penale më pak në vitin 2016.

VITET	SHUMA	
	Çështje	Të pandehur
2015	253	276
2016	243	265

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për 244 çështje të gjykuara është vendosur deklarimi i pafajshëm i 6 të pandehurve.

Pafajësitë janë paraqitur në tabelën në vijim:

Nr	Emër Mbiemër	Vendimi Gjykatës	Dt. Vendimi	Neni	Prokurori ankimues
1	Sami Vokshi	256-46	10.03.2016	300	Shkëlzen Cena
2	Esat Lika	557-104	19.05.2016	146	Bardhyl Shehu
3	Klodjan Isufi	755-142	30.06.2016	84	Bardhyl Shehu
4	Fran Kokaj	953-174	16.09.2016	290/3	Bardhyl Shehu
5	Mariglen Stojani	1444-362	27.12.2016	300	Arben Nika
6	Sandër Rica	1444-362	27.12.2016	300	Arben Nika

4.4 Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si: gjinia, mosha, arsimi, punësimi, etj.

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i personave të mitur që kryejnë vepra penale nuk është shumë i lartë. Kështu rezulton se janë regjistruar si autorë të veprave penale 3 persona të mitur, që të tre meshkuj. Si zakonisht në më të shumtën e rasteve të evidentuara veprat penale kryhen nga të rriturit dhe në të shumtën e rasteve nga meshkujt. Nga 262 persona të rritur, autorë të veprave penale, vetëm 10 prej tyre janë femra.

Në përgjithësi ka një raport të drejtë në nivelin e arsimit të personave autorë të veprave penale. Kështu evidentohet se 124 persona janë me arsim 8-vjeçar dhe 132 të tjerë janë me arsim të mesëm dhe 6 me arsim të lartë dhe 186 prej tyre janë të papunë. Vetëm një pjesë e vogël janë të punësuar apo të vetëpunësuar.

Evidentohet se shumica e personave që kryejnë vepra penale banojnë në zonat rurale dhe pjesa tjetër në qytet. Kështu sipas statistikave, 179 autorë të veprave penale banojnë në fshat dhe 80 banojnë në qytet.

4.5 Të dhëna për të pandehurit e mitur (numri i procedimeve të regjistruara)

Gjatë vitit 2016, janë regjistruar 27 procedime penale me 17 të pandehur, nga të cilët 7 të arrestuar, ku pas kryerjes së veprimeve të para është deklaruar moskompetenca dhe aktet i kanë kaluar për kompetencë hetimi, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksionit për hetimin e të miturve dhe Prokurorisë për Krime të Rënda në Tiranë.

4.6 Të dhëna për pasojat e veprave penale

Sa u përket të dhënave lidhur me pasojat e veprave penale, sipas statistikave rezulton se për vitin 2016 ka patur 6 raste të plagosjes së rëndë dhe asnjë rast të plagosjes së lehtë në dëm të shëndetit të personit. Janë regjistruar gjashtë raste vdekjesh për shkak të veprave penale.

V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

5.1 Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë), njohje vendimi, transferim procedimi, ekzekutim letër porosie, etj.

Nga të dhënat e verifikuara rezulton se gjatë vitit 2016 nuk janë kryer ekstradime për jashtë shtetit apo nga jashtë të personave të pandehur. Janë ekzekutuar 17 letër porosi nga jashtë shtetit, në përgjithësi për njoftim të akteve të personave të dënuar. Gjithashtu janë dërguar në gjykatë dhe 8 kërkesa për njohje të vendimeve të huaja penale dhe janë lëshuar 4 urdhra kërkimi ndërkombëtar.

VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

6.1 Ngarkesa specifike e punës për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin gjatë vitit 2016 ka funksionuar me katër prokurorë dhe tre oficerë të policisë gjyqësore. Me këtë kapacitet mendojmë se janë përmbushur më së miri detyrimet ligjore të organit të akuzës së Kurbin, duke marrë në konsideratë ngarkesën e secilit.

Kjo ngarkesë pune paraqitet si më poshtë:

Prokurori Hysni Vata. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 56 procedime penale në total. Ka dërguar për gjykim 17 procedime, ka vendosur pushimin për 3 procedime, ka pezulluar hetimet për 15 procedime dhe për 1 procedim ka vendosur transferimin.

Prokuori Ajola Prençi. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 125 procedime penale në total, përfshirë këtu edhe hetime të viteve të kaluara. Ka dërguar për gjykim 28 procedime, ka

vendosur pushimin për 7 procedime, ka pezulluar hetimet për 58 procedime dhe për 9 procedime ka vendosur transferimin.

Prokuori Shkëlzen Cena. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 141 procedime penale në total, përfshirë këtu edhe hetime të viteve të kaluara. Ka dërguar për gjykim 62 procedime, ka vendosur pushimin për 32 procedime, ka pezulluar hetimet për 42 procedime. Numri total i procedimeve të zgjidhura prej tij është 136.

Prokuori Bardhyl Shehu. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 175 procedime penale në total, përfshirë këtu edhe hetime të viteve të kaluara. Ka dërguar për gjykim 92 procedime, ka vendosur pushimin për 25 procedime, ka pezulluar hetimet për 42 procedime dhe për 5 procedime ka vendosur transferimin.

Prokuori Arben Nika. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 155 procedime penale në total, përfshirë këtu edhe hetime të viteve të kaluara. Ka dërguar për gjykim 44 procedime, ka vendosur pushimin për 16 procedime, ka pezulluar hetimet për 63 procedime dhe për 9 procedime ka vendosur transferimin.

Tabela në vijim pasqyron ngarkesën e prokurorëve me ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim gjatë vitit 2016

Prokurorët	Hetime totale	Procedime të Përfunduara	Gjykime	Pezullime	Pushime	Transferime	Mbartur
H.Vata	56	37	17	15	3	1	19
Sh.Cena	141	136	62	42	32	0	0
B.Shehu	175	164	92	42	25	5	16
A.Nika	155	134	44	63	16	11	0
A.Prençi	125	102	28	58	7	9	23
TOTALI	652	573	243	220	83	24	79

Hetimi për vitin 2016 është mbuluar nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë dhe nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë e të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë. Përgjithësisht, delegimi i procedimeve penale është bërë sipas sugjerimit që kanë bërë Komisarati i Policisë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, duke u deleguar procedimet oficerëve që kanë referuar materialin dhe kanë kryer veprimet kryesore proceduriale dhe hetimore. Në disa raste sugjerimi për delegim është bërë për oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit që mbulojnë zonën ku ka ndodhur vepra penale.

Oficerët e policisë gjyqësore të strukturës pranë Prokurorisë Nik Ndoci, Nikolin Marku dhe Erenik Muhametaj për vitin 2016 kanë përbulluar ngarkesë të konsiderueshme materiale dhe procedimesh penale. Përgjithësisht, oficerët e policisë gjyqësore të strukturës pranë Prokurorisë kanë kryer veprimet verifikuese për shumicën e materialeve në fazën verifikuese si dhe kanë ndjekur në hetim procedimet penale të regjistruara mbi kallëzimet e qytetarëve dhe procedime të tjera të referuara nga policia.

Por, gjatë vitit 2016, oficerët e policisë gjyqësore të strukturës së Prokurorisë krahas me hetimin janë ngarkuar edhe me detyra të tjera sipas nevojave që ka diktuar puna në sektorë të ndryshëm të Prokurorisë, psh.: me mbajtjen e Regjistrimit Elektronik dhe Statistikën Elektronike, ndjekjen e ekzekutimeve të vendimeve penale, mbajtjen e dosjeve dhe ekzekutimeve penale, etj.

Puna e policisë gjyqësore e strukturës pranë Prokurorisë dhe e atyre pranë Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, vlerësohet pozitivisht, jo vetëm për dokumentimin e mirë të veprave penale, por edhe për hetimin me shpejtësi e pa zvarritje të procedimeve penale.

Tabela më poshtë pasqyron ngarkesën e oficerëve të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë për vitin 2016.

O.P.GJ	Hetuar	Pezullime	Pushime	Transferime	Gjykime	Hetim
N.Ndoci	107	7	21	4	62	13
N.Marku	57	14	14	0	33	14
E. Muhametaj	10	6	4	0	22	3

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe veçanërisht me ato të Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë dhe Komisariatin e Policisë Kurbin ka qenë në nivele shumë të mira. Me drejtuesit e këtyre institucioneve janë zhvilluar takime të shpeshta pune, ku janë diskutuar problemet e ndryshme të hetimit dhe ndjekjes penale. Takime janë zhvilluar edhe me oficerët e strukturës së policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Kurbin për probleme që janë evidentuar në kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore dhe proceduriale.

Edhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin bashkëpunimi ka qenë në nivele shumë të mira, gjithmonë duke respektuar etikën profesionale dhe kërkesat e ligjit procedural penal.

6.2 Ushtrimi i rolit dhe kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë

Në veprimtarinë e ndjekjes penale për çështjet e hetuara dhe të përfaqësuara në gjykim, një rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesi në lidhje me studimin dhe vendimmarrjen për regjistrimin e çështjeve penale, kontrollin në dinamikë, mënyrës së përfundimit të çështjeve, si dhe krijimit të marrëdhënieve me Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Prokurorisë, seksioneve dhe shërbimeve të Policisë si dhe me institucione të tjera.

Gjatë periudhës që analizojmë nga Drejtuesit e Prokurorisë është ushtruar studimi i të gjitha materialeve kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore e ato me vendngjarje, duke marrë masa për shpërndarjen e tyre në bazë të ngarkesës dhe gatishmërisë. Në të gjitha rastet është bërë përpjekje për një respektim të një proporcionaliteti në shpërndarjen e ngarkesës për prokuror dhe oficerë të policisë gjyqësore, kjo e evidentuar dhe në statistikën e lartëpërmendur.

Urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm janë punuar dhe diskutuar për zbatimin e tyre. Është ushtruar kontroll në dinamikë të çështjeve penale gjatë hetimeve paraprake, janë evidentuar dhe kërkuar verbalisht veprime konkrete që duhet të kryhen.

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Në mbarëvajtjen e punës të veprimtarisë së Prokurorisë, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e Prokurorisë. Rezulton tashmë një evidencë e saktë dhe e qartë që nga momenti i protokollimit të materialeve në kryesekretari e më pas në regjistrat e kallëzimeve, procedimeve penale, të mosfillimeve, të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, etj mbajtur nga sekretari i regjistrit.

Të gjitha kallëzimet dhe procedimet janë regjistruar në sistemin CAMS duke operuar me kujdes në këtë sistem për të pasqyruar saktë të dhënat përkatëse në bashkëpunim dhe me strukturën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Po nga Kryesekretaria janë evidentuar me korrektësi shpenzimet procedurale të çështjeve penale të parapaguara nga shteti e të mbajtur nga prokurorët. Gjithashtu është mbajtur evidencë e saktë në lidhje me pagesat honorare për vitin 2016. Janë shlyer detyrimet për ekspertë autoteknikë, mjeko-ligjor, avokatë, përkthyes, teknikë vlerësues, ekspertë kontabël, MZSH në shumën 1.407.250 lekë. Shpenzime të mbartura për 2017 për avokatë, ekspertë, mjeko-ligjorë, përkthyes, etj në shumën 136.000 lekë.

Në kuadër të zbatimit të V.K.M Nr.591, datë 23.07.2010 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore" nga ana jonë po bëhen përpjekje për një menaxhim sa më optimal të këtyre fondeve.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit e prokurorisë. Është ushtruar kontrolli i brendshëm për zbatimin e tyre dhe në raste të caktuara të mosrespektimit janë marrë dhe masa të tilla si heqja e ditës së punës, etj. Kodi i Etikës parashikon standarde të qarta dhe të detyrueshme sjelljeje për prokurorët, në thelb të të cilave qëndron detyrimi që ata të veprojnë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe efektivitetin e drejtësisë penale.

VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur në analizë të tyre duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin 2017 në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

Ndër drejtimit e kryesore të punës duhen vlerësuar:

Së pari, një ndër drejtimit kryesore të veprimtarisë së punës për vitin 2017 është ngritja e cilësisë së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale. Cilësia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Oficeri të Policisë Gjyqësore, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimin dhe arsyetimin ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare si dhe përfaqësimit në Gjykatë.

Së dyti, duhet rritur ndjeshëm kontrolli në dinamikë nga ana e Prokurorëve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar me nxjerrjen e një urdhri për kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri në ardhjen e akteve nga shërbimet dhe Seksionet e Policisë Gjyqësore, duke

shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimor që mund të rezultojë gjatë dinamikës, etj. Në dinamikë gjatë kontrollit të veprimtarisë hetimore nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, Prokurori duhet të jetë jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerrë akte procedurale për veprime specifike si kontrole, përgjime, etj, por duhet të jetë dhe iniciues, apo nxitës për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione Drejtuesit e Prokurorisë problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qoftë që kanë të bëjnë dhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimtarisë hetimore, siç janë zvarritjet e pajustificueshme, etj.

Së treti, për çështje të veçanta për shkak të rrezikshmërisë shoqërore, apo përhapjes së një krimi, duke iu referuar tendencës së kriminalitetit, aq më tepër për çështje të rënda dhe sensitive duhet bërë vlerësimi i diferencuar, duhet kryer analiza e vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore. Gjithashtu nga evidentimi i një mangësie të vitit 2016 në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore nga vetë Prokurorët, këtë vit duhet vlerësuar me korrektësi sidomos zbatimi i nenit 256 të Kodit të Procedurave Penale në lidhje me pyetjen e të arrestuarve, apo delegimi i përfundimit të hetimeve. Marrja kontakt që nga momentet e para nga prokurori me të dyshuarin (arrestuarin/hetuarin/pandehurin) krijon një perceptim më të drejtë në lidhje me hetimet që do të kryhen më pas, shmang dhe probleme procedurale në lidhje me zgjedhjen e masës shtrënguese të marrë nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, si dhe për krijimin e një politike të drejtë të kërkesës për masë sigurimi, bazuar dhe në personalitetin e të dyshuarit, etj.

Në prioritetet për vitin 2017 në vazhdim:

Së pari, evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara, apo evidentuara kryesisht që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore apo private. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndihet një shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

Së dyti, kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, por edhe me faktorë të tjerë, ku duhen përmendur veprat penale kundër pasurisë, kundër autoritetit të shtetit dhe korrupsionit, duke rritur rastet e hetimeve proaktive dhe veprimeve simuluese.

Së treti, rifillimi i çështjeve të pezulluara sipas nenit 326 të Kodit të Procedurave Penale për veprat penale të rënda, siç janë vrasjet e pazbuluara, të cilat rezultojnë në një numër të konsiderueshëm të pezulluara dhe raste sporadike referimi për rifillim hetimesh.

Së katërti, rritjen e vëmendjes së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në përdorimin e sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.

Analizës i bashkëlidhen edhe tabelat përkatëse me treguesit statistikorë 2 vjeçarë.

DREJTUESI I PROKURORISË

HYSNI VATA